



Prishtinë, 10.12.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1337_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085);
- Nenin 16 paragrafi 3 nënparagrafi 3.7 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Kërkesën e Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO) për amendamentimin e Kodit të Matjes të Energjisë Elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të datës 18.11.2019,

në seancën e mbajtur me datë 10.12.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - amendamenti i dokumentit “Kodi i Matjes të Energjisë Elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” si në shtojcë të këtij vendimi.

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18.11.2019 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e dokumentit “Kodi i Matjes të Energjisë Elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” të harmonizuar me legjislacion në fuqi. Në këtë kuadër janë shtuar disa plotësime dhe ndryshime, si dhe është bërë përshtatja e termave sipas legjislacionit në fuqi.
- o ZRRE ka dhënë komente lidhur me dokumentin gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO.
- o Pas përfshirjes së të gjitha komenteve dhe finalizimit të dokumentit, KQKO me datë 30.11.2020 ka dërguar dokumentin “Kodi i Matjes të Energjisë Elektrike të Operatorit të



Sistemit të Shpërndarjes” në ZRRE me kërkesën për aprovimin e amandamentimit të tij.

- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës së KQKO për amandamentim e dokumentit “Kodi i Matjes të Energjisë Elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, ka vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat teknike dhe procedurale, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- II. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi nr. V_617_2014 i aprovuar nga Bordi i ZRRE-së.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Dokumenti “Kodi i Matjes të Energjisë Elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” i amandamentuar.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KEDS.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së


Arsim Janova, u.d. kryesuesit


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar